

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**AL DEVELOPMENT SHPK**

Sot, më datë 29.1.2024,

**Z. VLADIMIR UKU**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më datë 25.05.1982, me banim në adresën Nd. 18, H. 1, Rr. Tafil Agaj, Njësia Administrative Nr 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1022, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës nr. BD17228339,

ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është **AL DEVELOPMENT SHPK**.

**Neni 2 - Vendi i ushtrimit të aktivitetit (Selia)**

Vendi i ushtrimit të aktivitetit të Shoqërisë është në Kati 13, Pall. ETC, Blvd, Bajram Curri Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i Veprimtarisë**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt kryesor ndërtimin e ndërtesave rezidenciale dhe jo rezidenciale.
- 4.2 Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj aktiviteti lidhur me ndërtimin e objekteve civile, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj, pa u kufizuar vetëm në:
- projektim dhe zbatim të veprave ndërtimore si vijon: ndërtime me karakter civil dhe ekonomik, punime/gërmime dhe sistemime dheu, tarracime terrenesh; rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, ndërtime urash dhe konstruksione metalike, montime panelesh, ndërtime rrugesh, asfaltime, hapje kanalesh si dhe çdo ndërtim tjetër me karakter civil dhe ekonomik si dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet dhe është i nevojshëm për objektin e mësipërm.
  - Prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import -eksport i tyre, brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vet shoqërisë si dhe të tretëve, ku



- perfshihen inerte, gur, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llac, cemento, rërë dhe cdo material tjetër për ndërtimin.
- Shitje-blerje pasuri të patundshme etj si dhe cdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.
- 4.3 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të fitojë interesa, direkt ose indirekt, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe objekte të tjera aktiviteti.

### **Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 Lekë (njëqind), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 100 Lekë (njëqind).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar në para dhe paguar plotësisht si më poshtë vijon:
- **Z. VLADIMIR UKU**, shtetas shqiptar, lindur në Tirane, më datë 25.05.1982, me banim në adresën Nd. 18, H. 1, Rr. Tafil Agaj, Njësia Administrative Nr 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1022, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i pasaportës nr. BD17228339, i cili ka kontribuar me para në kapitalin e Shoqërisë me një shumë të barabartë me 100 (njëqind) Lekë.

### **Neni 6 - Kontributet**

- 6.1 Në bazë të kontributeve të sipërcituara, në momentin e themelimit:
- Z. Vladimir Uku zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (njëqind për qind) të kapitalit themeltar.

### **Neni 7 - Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### **Neni 8 - Administrimi**

- 8.1 Me këtë akt emërohet me afat 5 (pesë) vjeçar, 1 (një) Administrator i Shoqërisë, personi si më poshtë:
- **Znj. Mediola Sopiçoti**, shtetase shqiptare, lindur në Fier, më datë 19.10.1990, me banim në adresën Nd.12 Ap,4, Rr. Mine Peza, Njësia Administrative Nr. 9, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e pasaportës nr. BA5375164.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Statutit.
- 8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'i drejtohet për ndihmë të tretëve ose

konsulentëve të cilëve mund t'i delegojë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

### **Neni 9 - Gjuha**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Asambleja e Përgjithshme/Ortaku i Vetëm themelues i shoqërisë tregtare "AL DEVELOPMENT" SHPK nenshkrhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemtin dhe firmën e tij.

\* \* \*

### **ORTAKU I VETËM**

### **I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

### **AL DEVELOPMENT SHPK**

VLADIMIR UKU



---

**Z. VLADIMIR UKU**